



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 423/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.06.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “MB Kurti” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-53236-03-01-2018, me objekt: “Blerje ushqimesh”, me fond limit 4 840 000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 15.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mat.

Ankimues:

“Nelsa” sh.p.k
Qesarak, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Mat
Sheshi “Ahmet Zogu”, Burrel

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.03.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-53236-03-01-2018, me objekt: “Blerje ushqimesh”, me fond limit 4 840 000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 15.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mat.

II.2. Në datën 04.04.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|------------------------------|
| 1. “M.B.Kurti” sh.p.k | 3.885.500 lekë, kualifikuar |
| 2. “Nelsa” sh.p.k | 4.330.510 lekë, kualifikuar |
| 3. “Erdis” sh.p.k | 4.731.520 lekë, skualifikuar |

II.3. Në datën 10.04.2018 operatori ekonomik “Nelsa” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e shoqërisë “MB Kurti” sh.p.k në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet:

“[...] Nga informacioni konfidencial që kemi, edhe nga procedurat e tjera të prokurimit, konstatojmë se operatori ekonomik “Sinani Trading” sh.p.k (“M.B.Kurti” sh.p.k), nuk i plotëson të gjitha kriteret kualifikuese të përcaktuara në DST.

Kështu ky operator ka mangësi të theksuara në kontratat e ngjashme, pasi po të shikohen me vëmendje nga ana e KVO-së nuk janë të plota dhe të sakta ...

Po ashtu dhe në dokumentacionin e dorëzuar për objektet thertore, sera dhe magazina ushqimore ka plot probleme për tu trajtuar, nuk përputhen me kërkesat e përcaktuara nga ana juaj në DST, por nga ana e KVO-së janë anashkaluar..

Sic shihet nga vlerësimi AK të tjera kërkesa për pjesëmarrje publikon në sistemin e APP-së dhe këto kërkesa në vlerësim i anashkalon.

Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është (janë) pëdorur qëllimisht këto arsye skualifikuese, duke shkelur hapur kriteret e pjesëmarrjes, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, e VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shoqëria jonë është trajtuar në mënyrë diskriminuese nga KVO-ja, duke kualifikuar qëllimisht operatorin ekonomik i cili është me mangësi në dokumentacionin e dorëzuar. Të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas dst nuk është dorëzuar në rregull nga ana e operatorit ekonomik “Sinani Trading” sh.p.k (“M.B.Kurti” sh.p.k), por KVO-ja nuk ka zbatuar drejtë kërkesat e ligjit për vlerësimin e kësaj procedure [...]”.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 980 prot., datë 13.04.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke refuzuar ankesën.

II.5. Në datën 20.04.2018 operatori ekonomik “Nelsa” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar:

“[...] Operatori ekonomik “Sinani Trading” sh.p.k (“M.B.Kurti” sh.p.k), nuk plotëson të gjitha kriteret kualifikuese të përcaktuara në dst. Kështu kontrata e furnizimit me Bashkinë Fier nuk mund të merret parasysh, pasi nuk mund të vlerësohet në cfarë mase (%) është plotësuar kjo kontratë nga ana e “MB Kurti” sh.p.k. Kontrata është lidhur me bashkim operatorësh dhe nuk është përcaktuar % që ka ky operator. Edhe vërtetimi i lëshuar nga ana e Bashkisë Fier “Vërtetim realizimi”, nuk i përgjigjet kontratës së furnizimit me nr. prot., 1103, datë 03.04.2017 të paraqitur në sistemin e APP-së nga ana e “MB Kurti” sh.p.k.

Kontrata e furnizimit me Spitalin Fier nuk mund të merret parasysh, pasi vërtetimi i lëshuar nga ana e Spitalit Fier “Vërtetim realizim kontrate”, nuk i përgjigjet kontratës së furnizimit me nr.prot., 878, datë 01.03.2017 të paraqitur në sistemin e APP-së nga ana e “MB Kurti” sh.p.k.

Kontrata e furnizimit me Spitalin Fier me nr. prot., 62, datë 09.01.2017, të paraqitur në sistemin e APP-së nga ana e “MB Kurti” sh.p.k, nuk plotëson vlerën 40% të fondit limit sic kërkohet në DST.

Kapaciteti teknik thertore në marrëveshje në kontratën e furnizimit të zyrtarizuar, nuk përmban të dhëna të plota si: telefon, website etj., kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi, sic kërkohet në dst.

Në kontratën e qirasë për serë, për prodhimin e perimeve të freskëta nuk ka të dhëna të plota si: licencë, telefon, email, website etj., kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi.

Në këtë kontratën e qirasë theksohet se: Me marrëveshjen e kontratës qiradhënësi zhvishet nga detyrimet ligjore karshi shtetit dhe të tretëve, për të cilat gjatë priudhës së përdorimit, do të përgjigjet qiramarrësi. Kontrata është lidhur që më datë 12.09.2017 dhe nga ana e “MB Kurti”

sh.p.k nuk është shënuar në QKB (vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit), si rrjedhojë nuk janë paguar as detyrimet vendore karshi shtetit.

Për magazinën ushqimore dhe ambiente frigoriferike, kontratës së qirasë nuk i është bashkëlidhur asnjë dokument shoqërues, as leje legalizimi dhe as vërtetim nr. 448, datë 07.02.2018. KVO nuk mund të gjykojë dhe të marrë vendim të saktë për këtë kontratë.

Për automjetin me targë AA324 FN tek leja higjieno sanitare, nuk përputhet numri i shënuar te NIPT-i me asnjë NIPT të operatorëve që kanë bërë kontratën.

Automjeti me targë LU 7111B sipas lejes së qarkullimit nukë shtë ATV (frigo) [...]” .

II.6. Në datën 02.05.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 789/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1124 prot., datë 30.04.2018 me objekt: “*Dërgim dokumentacioni*”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nelsa” sh.p.k se: “[...] “*Sinani Trading*” sh.p.k (“*M.B.Kurti*” sh.p.k), [...] *ka mangësi të theksuara në kontratat e ngjashme*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*” gërma “a” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është parashikuar plotësimi i kërkesës si vijon:

“*Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:*

- a) “*Dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2015, 2016, 2017), në vlerë jo me pak se 40 % te fondit limit qe prokurohet. Kjo do te vertetohet me dokumentat e meposhtme:*
- *Për kontrata me institucionet shtetërore për përvojën e mëparshme duhet te paraqiten vërtetime realizimi të lëshuara nga institucionet perkatese me te cilat keni realizuar kontraten, ku shënohen datat, shumat, sasite dhe shërbimet e realizuara.*
 - *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, te firmosura e te konfirmuara nga bleresi dhe shitesi ku te percaktohen qarte, datat, shumat, sasite dhe shërbimet e realizuara..”*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “MB Kurti” sh.p.k, rezulton se, është paraqitur si vijon:

- Kontratë nr. 878 prot., datë 01.03.2017 e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Spitali Rajonal Fier dhe operatorit ekonomik “MB Kurti” sh.p.k, me objekt “*Bleje ushqime për nevoja spitalore*”. Vlera e kontratës është 4.950.575 lekë pa tvsh dhe 5.940.690 lekë me TVSH.
- Kontratë shtesë nr.62 prot., datë 09.01.2017 e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Spitali Rajonal Fier dhe operatorit ekonomik “MB Kurti” sh.p.k me objekt: “*Blerje ushqimesh për Spitalin Rajonal Fier*”. Vlera e kontratës është 388.860 lekë pa TVH dhe 466.632 lekë me TVSH.
- Kontratë shit-blerje nr.08/602/2016 me nr. 1103 prot., datë 03.04.2017 e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Fier dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “MB Kurti” sh.p.k & “GEA” sh.p.k, me objekt: “*Blerje produkte ushqimore*”. Vlera e kontratës është 17.030.630 lekë pa TVH dhe 20.436.756 lekë me TVSH.
- Vërtetim nr. 377 prot, me objekt: “*Vërtetim për realizim kontrate*”, lëshuar në datën 25.01.2018 nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier.
- Vërtetim nr. 71 prot., datë 31.01.2018, lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përkthyer nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”

III.1.5. Në nenin 27 “*Kontratat e Mallrave*”, pika 4 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar parashikohet se “*Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:*

- *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllëgaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*
- *Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.1.6. Referuar dokumentacionit sa më sipër të paraqitur nga operatori ekonomik “MB Kurti” sh.p.k, në përmbushje të kërkesës së autoritetit kontraktor për eksperiencë të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, konstatohet se:

Vërtetimi nr. 377 prot, me objekt: “Vërtetim për realizim kontrate”, lëshuar në datën 25.01.2018 nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier, vërteton realizimin me sukses të kontratës shtesë nr.62 prot., datë 09.01.2017, me objekt: “Blerje ushqimesh për nevoja spitalore”, në vlerën 466.632 lekë me TVSH. Ndërsa për kontratën nr. 878 prot., datë 01.03.2017, e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Spitali Rajonal Fier dhe operatorit ekonomik “MB Kurti” sh.p.k, me objekt “Blerje ushqime për nevoja spitalore” dhe vlera kontrate 4.950.575 lekë pa tvsh e 5.940.690 lekë me TVSH, vërtetimi i mësipërm i lëshuar nga Spitali Rajonal Fier nuk jep informacion.

Gjithashtu Vërtetimi nr. 71 prot., datë 31.01.2018, lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier vërteton se operatori ekonomik “MB Kurti” sh.p.k ka patur kontratë furnizimi nr. 8, datë 03.04.2017, me vlerë 20.436.756 lekë me TVSH me Qendrën Ekonomike të Arsimit, Bashkia Fier. Operatori ekonomik “MB Kurti” sh.p.k. ka paraqitur kontratën shit-blerje nr.08/602/2016 me nr. 1103 prot., datë 03.04.2017, lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Fier dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “MB Kurti” sh.p.k & “GEA” sh.p.k, me objekt: “Blerje produkte ushqimore”, vlera e të cilës është 17.030.630 lekë pa TVH dhe 20.436.756 lekë me TVSH. Në këtë kontratë nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me përqindjen që ka secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë “MB Kurti” sh.p.k & “GEA” sh.p.k, në mënyrë që të përlllogaritet pjesa e furnizimit të realizuar nga shoqëria “MB Kurti” sh.p.k e që rrjedhimisht të verifikohet nëse e përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Kontrata e lidhur me Bashkinë Fier ka të përcaktuar se si operator ekonomik është bashkimi i shoqërive “MB Kurti” sh.p.k. & “GEA” sh.p.k, dhe si e tillë duhet që të vërtetohet sa është pjesa e përqindjes së marrë përsipër prej secilit prej këtyre anëtarëve, ndërkohë që edhe në vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Fier nuk jepet asnjë e dhënë në lidhje me këtë përqindje, por thuhet se shoqëria “MB Kurti” sh.p.k ka patur kontrata furnizimi për produkte ushqimore me Qendrën Ekonomike të Arsimit, Bashkia Fier, të realizuar me korrektësi, edhe pse në kontratën e lidhur është përcaktuar qartë që kjo kontratë lidhet me bashkimin e operatorëve ekonomikë dhe jo vetëm me shoqërinë “MB Kurti” sh.p.k. Sa më sipër, kjo kontratë e paraqitur nuk mund të merret në konsideratë për shkak të mangësive që ajo ka, konkretisht mosparaqitja e përqindjes që ka secili operator ekonomik në këtë bashkim operatorësh, me qëllim që të bëhet përlllogaritja e vlerës së kontratës së ngjashme të mëparshme të operatorit ekonomik “MB Kurti” sh.p.k., në përputhje me përqindjen e bashkëpunimit të marrë përsipër për realizimin e kësaj kontrate, referuar, kontratës së bashkëpunimit me operatorin ekonomik “GEA” sh.p.k.

Në kushtet kur merret në konsideratë vetëm kontrata shtesë nr.62 prot., datë 09.01.2017 e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Spitali Rajonal Fier dhe operatorit ekonomik “MB Kurti” sh.p.k me objekt: “Blerje ushqimesh për Spitalin Rajonal Fier”, vlera e të cilës është 388.860 lekë pa TVH dhe 466.632 lekë me TVSH, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se operatori ekonomik “MB Kurti” sh.p.k. nuk arrin të përmbushë kriterin për kontrata të ngjashme, pasi nuk plotëson vlerën për kontrata të ngjashme. Theksojmë se në kriteret e vecanta të kualifikimit, është

parashikuar shprehimisht që kur ofertuesi dorëzon kontrata me institucionet shtetërore për përvojën e mëparshme, duhet te paraqiten vërtetime realizimi të lëshuara nga institucionet perkatëse me të cilat keni realizuar kontratën, pra nga tre kontratat e paraqitura nga “MB Kurti” sh.p.k, vetëm ajo me vlerë 388.860 lekë pa TVH, është shoqëruar me vërtetim realizimi konform kërkesave të autoritetit kontraktor, por vlera e saj nuk përmbush vlerën e kërkuar jo më pak se 40% të fondit limit. Gjithashtu kontatohet se vërtetimet e realizimit të cituara si më sipër, përmbajnë informacion edhe për kontrata të tjera, por duke qënë se nga ana e këtij subjekti nuk janë paraqitur fizikisht kontratat e përmendura në këto vërtetime, Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund ti marrë në konsideratë si eksperiencia të mëparshme pasi nuk janë shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm të parashikuar nga autoriteti kontraktor, apo nuk japin informacion të hollësishëm lidhur me shumtat, sasite dhe shërbimet (furnizimet) e realizuara, në kundërshtim me kriterin e parashikuar në dokumentat e tenderit dhe nenin 46, pika 1 të LPP-së. Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

III.1.7. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën procedurën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në këto kushtë, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “MB Kurti” sh.p.k, në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “MB Kurti” sh.p.k nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Nelsa” sh.p.k për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “MB Kurti” sh.p.k. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur interes të ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e

rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nelsa” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-53236-03-01-2018, me objekt: “*Blerje ushqimesh*”, me fond limit 4 840 000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 15.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mat.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “MB Kurti” sh.p.k, dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si mësipër, duke e skualifikuar këtë ofertues.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Nelsa” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 789 Protokoli,
Datë 20.04.2018



Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Kryetar
Evis Shurdha